



PROFILI I ORGANIZATËS

KUSH JEMI NE:

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë është themeluar në vitin 2016, si një organizatë biznesi, e bazuar në ligjin për “Organizatat jo-fitimprurese” në Republikën e Shqipërisë.

Kjo organizatë përfaqëson, mbron dhe mbështet interesat e përbashkëta për më shumë se 700 biznese prodhuese në 10 makrosektorë industrial dhe rreth 30 sektoret industrial në vend.

Zyrat e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë ndodhen në Tiranë, me perfaqësim te gjërë në territorin kombëtar.

QELLIMI YNË:

Qëllimi i organizatës është t'i shërbejë anëtarëve të saj, gjithashtu prodhimit vendas. Synon të mbështesë konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në shtetin Shqiptar përmes informimit të vazhdueshëm, mbështetjes, advocacy/lobbying si dhe në promovimin e produktit vendas.

AKTIVITETET TONA:

Shoqata është e fokusuar në promovimin, komunikimin, ndërgjegjësimin dhe informimin mbi të dhënat dhe të rejat e fundit mbi Konkurrencën, Mbrojtjen e Konsumatorit, Përgjegjësinë Sociale të Korporatave, Konkurrencën e Drejtë, Mbrojtjen e Mjedisit, Ekonominë Qarkulluese dhe çështje të tjera që lidhen ngushtë me prodhimin.

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë siguron asistencë profesionale dhe edukuese te anëtarët e saj duke organizuar trajnime dhe diskutime të vazhdueshme, gjithashtu vlerësimin e sipërmarrësve dhe produktet vendase.



Aktiviteti i shoqatës është gjithashtu i lidhur me sondazhe dhe kërkime të kryera në sektorin e prodhimit në Shqipëri, të ndjekura nga analiza krahasuese për çështje që prekin këtë prodhim, për të ndihmuar në rritjen e kapacitetit të prodhimit në mënyrë që sipërmarrësit të integrojnë standardet më të mira dhe moderne të prodhimit.

Organizata siguron këshillim publik dhe nismat ligjore për sektorin e prodhimit, si dhe ndihmon në hartimin e politikave kombëtare. Duke shtuar zhvillimin e një modeli përsa i përket Llobing dhe Advocacy me Qeverinë dhe Komisionin Parlamentar, për të promovuar politikat publike dhe legjislacionin në përfitim të anëtarëve të saj dhe jo vetëm.

Gjithashtu është e fokusuar për shpërndarjen e informacionit të vlefshëm në lidhje me prodhuesit dhe synon të krijojë marrëdhënie me Shoqata ose Organizata të ngjashme jashtë vendit, në mënyrë që të bëhet pjesë e rrjetit ndërkombëtar të prodhimeve.

ANËTARËT TANË:

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili është pjesë e grupeve të shumta të ministrive për të diskutuar përpjekjet e reja dhe sfidat në lidhje me prodhimin. Si një organizatë prestigjioze, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë është anëtare e Këshillit Ekonomik Kombëtar, Këshilli Kombëtar i Integritit në BE, Komiteti Kombëtar i Faksifikimit të Tregtisë, Grupi Punues Ndërmintor për Strategjinë e Specializimit të zgjuar dhe Grupin e Këshillimit Strategjik të Ministrit për Sipërmarrje, që përfaqësojnë interesin e anëtarëve dhe më gjerë.

Industritë Shqipëtare kanë zhvilluar bizneset e tyre në të gjithë vendin, duke përfshirë industritë: e agrikulturës, peshkimit, pijeve, tekstile, plastike, ndërtimit etj.

Këtë vit ne përfaqësojmë më shumë se 500 milionë Euro xhiro vjetore, mbi 15 mijë të punësuar, rreth 350 milionë Euro eksporte dhe 2 bilion Euro investime.



STRUKTURA

❖ **Asambleja e Përgjithshme**

E cila është e përbërë nga 50 anëtarë që përfaqësojnë 10 nga makrosektorët kryesorë.

❖ **Bordi Drejtues**

Bordi përbëhet nga 19 anëtarë midis kompanive anëtare të Asamblesë së Përgjithshme

❖ **Komitetet e Politikave**

- Komiteti i Përputhshmërisë Statutore dhe Etikës
- Komiteti i Legjislacionit, Taksave dhe Procedurave
- Komiteti i Konkurrueshmërisë, Tregëtisë dhe Promovimit
- Komiteti i Integritit Rajonal dhe BE-së.

❖ **Grupet e Punës**

Agroprocesues - është një nga sektorët makro më të rëndësishëm të AMU. Ky grup pune mbulon industrinë e ushqimit dhe pijeve që lidhen me bujqësinë, peshkimin, agroturizmin etj. Ky grup merr pjesë në tryeza të rumbullakëta, trajnime dhe konferenca me të gjithë palët e interesuara që mbrojnë mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu grupi është i përfshirë në shumë aktivitete vjetore si panairë dhe ngjarje promovuese për produktet Made in Albania.

Grupi i Ekonomisë Qarkulluese - është grupi më dinamik i organizatës. Anëtarët e këtij grupi bëjnë pjesë në sektore të ndryshëm duke përmendur: fabrikat e cimentos dhe tullës, plastikës dhe riciklimit. Qëllimi i tyre është influencimi i mbrotjes së mjedisit. Ky grup merr pjesë në tryeza të rumbullakëta, workshop-e, trajnime dhe konferenca me të gjithë palët e interesuara që mbrojnë mbrojtjen e mjedisit.



NE JEMI ANËTARË NË:

- ❖ Këshillin Ekonomik Kombëtar
- ❖ Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian
- ❖ Komiteti Kombëtar për Lehtësimin e Tregtisë
- ❖ Group Grupi ndërinstitucional i punës për "Smart Specialization"
- ❖ Group Grupi ndërinstitucional i punës për "Regulated Professionals "

BASHKËPUNIME:

- ❖ Marrëveshja e partneritetit u nënshkrua në Dhjetor 1016 me Klubin e Prodhuesit të Kosovës;
- ❖ Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në prill 2017 me Forumin Ekonomik Pan-Shqiptar (Shqipëri-Kosova-Maqedoni e Veriut);
- ❖ Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në maj 2018 me Shoqëria Shqiptare të Sigurimeve;
- ❖ Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në Dhjetor 2018 me Universiteti Evropian të Tiranës;
- ❖ Marrëveshjet e bërjes së firmimit u nënshkrua në Prill 2020 me Co-Plan (parti e Universitetit Polis);